



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 04.06.2015, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj –kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si Administrator i Fondeve Grant, të siguruar nga Agjencia suedeze për Zhvillimin e Bashkëpunimit ndërkombëtar (SIDA), nën fondin suedez të besimit, për fondin e besimit nr. TF 072239, për projektin e shërbimeve mjedisore me Shqipërinë”.
2. Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim si administrator i fondeve grant të siguruar nga qeveri të ndryshme nën fondin e përbashkët evropian të Ballkanit Perëndimor për projektin e detajuar të linjes hekurudhore Durrës – Tiranë dhe vlerësimin financiar/ekonomik të të gjithë rrjetit hekurudhor në Shqipëri”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Dashamir Peza, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Vexhi Muçmataj, Anila Agalliu, Petrit Vasili, Silva Caka, Arben Ristani, Eduard Halimi, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungon: Tom Doshi

Të ftuar:

Ylli Hoxha – Drejtor i Drejtorise se Mbrojtjes dhe Trajtimit te Pyjeve

Madalena Koja – Pergjegjese Sektori Juridik

Shpresa Mezini – Specialiste, Drejtoria e Integritimit ne BE dhe Koordinimit te Projekteve

Vaelid Zhezha – Keshilltar i Ministrit te Mjedisit per Marrdheniet me Parlamentin

Elona Mistrovica, Sektori i Huamarrjes

Brikena Jazxhi, specialiste, Drejtoria e Drejtimit te Borxhit Publik

Argita Totozani, Drejtore e Pergjithshme ne Drejtorine e Integritimit

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita, të nderuar kolegë!

Po fillojmë mbledhjen e sotme.

Në rendin e ditës kemi dy projektligje: projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si Administrator i Fondeve Grant, të siguruara nga Agjencia suedeze për Zhvillimin e Bashkëpunimit ndërkombëtar (SIDA), nën fondin suedez të besimit, për fondin e besimit nr. TF 072239, për projektin e shërbimeve mjedisore me Shqipërinë”, relatore është zonja Caka dhe projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim si administrator i fondeve grant të siguruara nga qeveri të ndryshme nën fondin e përbashkët evropian të Ballkanit Perëndimor për projektin e detajuar të linjes hekurudhore Durrës – Tiranë, ku relator është zoti Peza.

Fillojmë me çështjen e parë të rendit të ditës, me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si Administrator i Fondeve Grant, të siguruara nga Agjencia suedeze për Zhvillimin e Bashkëpunimit ndërkombëtar (SIDA), nën fondin suedez të besimit, për fondin e besimit nr. TF 072239, për projektin e shërbimeve mjedisore me Shqipërinë”.

Kush dëshiron nga të ftuarit të bëjë një prezantim të shkurtër të projektligjit?

Po, zoti Hoxha.

Ylli Hoxha – Po, ju faleminderit! Marrëveshja është miratuar në parim me vendimin nr. 10, date 14.01.2015 të Këshillit të Ministrave dhe është nënshkruar në datën 27 janar.

Objektivi i marrëveshjes është mbështetja e praktikave të qëndrueshme të menaxhimit të tokës dhe rritja e përfitimeve monetare dhe jomonetare të komuniteteve, në zona të caktuara të zbatimit të projektit, që kryesisht shtrihen në zona malore rurale, të prekshme nga erozioni.

Fushat që mbështeten nga ky projektligj janë pasqyruar dhe në relacionin bashkëlidhur projektligjit.

Fatmir Xhafaj – Po zoti Hoxha, nuk është e nevojshme, e kemi përpara relacionin. Keni ndonjë gjë tjetër për të shtuar? Relatorja?

Silva Caka – Nuk kam ndonjë gjë për të shtuar, ftoj deputetët ta votojnë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Caka!

Ka pyetje në lidhje me projektligjin? Nuk ka. Diskutime?

Kalojmë në miratimin në parim.

Kush është dakord në parim për projektligjin? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim?

Nuk ka.

Miratohet në parim.

Fillojmë votimin nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2, “Për hyrjen në fuqi”. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 2.

Fillojmë votimin në tërësi. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

E mbyllim këtë pikë të rendit të ditës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 04.06.2015, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj –kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim si administrator i fondeve grant të siguruara nga qeveri të ndryshme nën fondin e përbashkët evropian të Ballkanit Perëndimor për projektin e detajuar të linjes hekurudhore Durrës – Tiranë dhe vlerësimin financiar/ekonomik të të gjithë rrjetit hekurudhor në Shqipëri”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Dashamir Peza, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Vexhi Muçmataj, Anila Agalliu, Petrit Vasili, Silva Caka, Arben Ristani, Eduard Halimi, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungon: Tom Doshi

Të ftuar:

Elona Mistrovica, Sektori i Huamarrjes

Brikena Jazxhi, specialiste, Drejtoria e Drejtimit të Borxhit Publik

Argita Totozani, Drejtore e Përgjithshme në Drejtorinë e Integritetit

Fatmir Xhafaj - Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim si administrator i fondeve grant të siguruara nga qeveri të ndryshme nën fondin e përbashkët evropian të Ballkanit Perëndimor për projektin e detajuar të linjes hekurudhore Durrës – Tiranë dhe vlerësimin financiar/ekonomik të të gjithë rrjetit hekurudhor në Shqipëri”.

Nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës ka ardhur zonja Argita Totozani dhe nga Ministria e Financave: Elona Mistrovica dhe Brikena Jazxhi. Kush e do fjalën?

Brikena Jazxhi – Po, faleminderit! Kjo marrëveshje ka për qëllim dhënien e një granti në shumën 1 103 000 euro, që do të përdoret për rigjallërimin e hekurudhave shqiptare dhe zhvillimin e transportit hekurudhor, duke përmirësuar infrastrukturën hekurudhore dhe operacionet, si dhe garantimin e sigurisë dhe ndërveprueshmërisë. Projekti që pritet të realizohet nëpërmjet këtij projektakti paraqet rëndësi të madhe për gjallërimin e hekurudhave shqiptare, konkretisht të linjës hekurudhore Durrës – Tiranë – Rinas, e cila ka prioritetin parësor në rrjetin hekurudhor. Konkretisht, do të hartohet projektzbatimi i rikonstruksionit të linjës Durrës – Tiranë me degën Shkozë – Porti i Durrësit, projekt zbatimi i ndërtimit të linjës hekurudhore Tiranë – Rinas, si dhe vlerësimi ekonomik dhe financiar i të gjithë rrjetit hekurudhor.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit zonja Jazxhi!

Ka pyetje në lidhje me këtë projektligj? Nuk ka. ka diskutime? Shikoj që kolegët janë dakord.

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit. Kush është dakord për këtë projektligj? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nën për nën. Kush është dakord për nënin 1? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord?

Miratohet.

Faleminderit!

E mbyllem këtu mbledhjen e sotme. Falënderoj përfaqësuesit e ministrive.

MBLEDHJA MBYLLET